

BRIF MUJOR

shtator 2016

Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 (JuDGMeNT)

Pasqyra mujore publikohet në kuadër të Projektit “Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për EJK 2020 (JuDGMeNT)”, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane, me mbështetje financiare të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Qëllimi kryesor i Projektit është vendosja e mekanizmit të strukturuar nga organizatat qytetare për monitorimin e përmbushjes së masave/instrumenteve/prioriteteve nga dimensionin *Drejtësi*, konform Strategjisë së EJK 2020. Këto masa janë:

P.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: pasqyra e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës të gjyqtarëve dhe gjykatave;

P.2. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor sa i përket qasjes së lirë deri te informacionet, zbatimi i ekzekutiveve ndërkufitare dhe procedurave ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit;

P.3. Mbështetje të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK): Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe ofrimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit.

Për më shumë informacione për Projektin vizitoni linkun në vijim:
http://www.epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=131.

Cilësia, kompetenca dhe efikasiteti i gjyqtarëve dhe gjyqësorit

Këshilli Gjyqësor i RM, në mbledhjen e mbajtur më datë 5 shtator të vitit 2016, mori vendim për përzgjedhjen e 28 gjyqtarëve nëpër gjykatat e Republikës së Maqedonisë, në përputhje me vendimin paraprak për shpalljen e konkurseve për zgjedhjen e gjyqtarëve, të miratuar në mbledhjen e mbajtur në muajin gusht. Ky Vendim hasi në reagime nga shoqëria civile. Duke mos e kontestuar nevojën e gjyqtarëve në gjykatat e caktuara, “Rrjeti 23” theksoi se kjo është hera e tretë që Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë të zgjedh kryetarë të gjykatave dhe gjyqtarë në prag të zgjedhjeve të parashikuara të parakohshme.¹ Me këtë praktikë vazhdoi moszbatimi i prioriteteve të reformës që kanë të bëjnë me depolitizimin e emërimeve dhe avancimeve të gjyqtarëve, vlerësimin, procedurat disiplinore dhe shkarkimin, kurse Këshilli Gjyqësor vazhdon të zgjedh kryetarë të gjykatave dhe gjyqtarë, pa u bërë ndryshime paraprake në sistemin e zgjedhjes.

Në mbledhjet e tjera të mbajtura në muajin shtator, Këshilli Gjyqësor caktoi ushtrues detyre në pozitën e kryetarit të Gjykatës Themelore në Tetovë dhe të kryetarit të Gjykatës së Apelit në Shtip dhe mori vendime për shpalljen e konkursit për pozitën e cekura, si dhe konkursit për zgjedhjen e një

¹ Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë në periudhën paraprake zgjodhi tetë kryetarë të gjykatave dhe shpalli konkurs për zgjedhjen e dhjetë gjyqtarëve më datë 23.02.2016 dhe shtatë gjyqtarë më datë 06.04.2016, në të dyja rastet vetëm një ditë para shpërndarjes së planifikuar dhe të vazhduar të Kuvendit. Komunikata e plotë të “Rrjetit 23” është e aksesueshme në këtë link: <http://www.merc.org.mk/aktivnost/9/soopshtenie-po-povod-najaveniot-izbor-na-novi-28-sudii-od-strana-na-sudskiot-sovet-na-republika-makedonija>.



gjqytari të Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup nga radhët e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Gjatë muajit shtator u mbajtën trajnimet e planifikuara, përkatësisht trajnimi për zbatimin praktik të Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit, trajnimi për zbatimin e barrës së provës në rastet e diskriminimit në bashkëpunim midis Misionit të OSBE dhe Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe trajnimi për zbatimin praktikë të nenit 5 të KEDNJ në bashkëpunim me Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe IPA.

Greva e administratës gjyqësore, e cila filloi në muajin maj të vitit 2016, ndërkaq e njëjta u pezullua gjatë muajit gusht, u ndërpre në shtator, edhe pse nuk u përmbushën kërkesat paraprakisht të parashtruara të administratës gjyqësore.² Vendimi i këtillë rezultoi pasi që administrata gjyqësore u përball me presione³ të ndryshme, e që e vuri në dukje faktin se nuk merret parasysh rëndësia e të njëjtit sa i përket efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe qasjes deri te drejtësia.⁴

Këshilli i Buxhetit Gjyqësor vendosi që pagat e nëpunësve gjyqësorë për muajin maj të vitit 2016 të paguhen plotësisht, ndërkaq ndalesa në pagë, konform nenit 77 të Ligjit për shërbimin gjyqësor, të zbatohet me pagesën e pagës për muajin qershor të vitit 2016. Sipas sekretarit të përgjithshëm të Sindikatës së Punëtorëve të Administratës, organeve të jurisprudencës dhe shoqatave të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë kjo ishte edhe një tentativë që të gjunjëzohet greva e administratës gjyqësore dhe të tërhiqet vëmendja nga problemet e nëpunësve gjyqësorë. Këshilli i Buxhetit Gjyqësor (KBGJ) të punësuarve nëpër gjykata u dërgoi njoftim në të cilin qëndron se në mënyrë kolektive do t'u zvogëlohen pagat për 40% për ata muaj në të cilët administrata gjyqësore ishte hedhur në grevë. Ky Vendim i KBGJ u miratua disa ditë pas Vendimit të parë në të cilin nga kryetarët e gjykatave kërkohej të përgatisnin aktvendime me paga të zvogëluara për 60% për të punësuarit të cilët dy muaj janë hedhur në grevë duke kërkuar paga më të larta. Gjendja e këtillë faktike, mes tjerash, vë në dukje se në vend të negociatave mbi nëpunësit gjyqësor janë bërë presione nga ana e Këshillit të Buxhetit Gjyqësor dhe nga kryetari i Këshillit Gjyqësor, e që është e patolerueshme për Këshillin Gjyqësor si një organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit dhe e vë në dukje jotransparencën gjatë punës së të njëjtit.⁵

Greva e administratës gjyqësore padyshim se kishte efekt negativ, me ç'rast u vu në pikëpyetje funksionimi i gjykatave. Megjithatë, duhet të theksojmë se në një shoqëri demokratike e njëjta është e drejtë e garantuar dhe mundësia për ta penguar nuk ishte përjashtuar, nëse palët e interesuara binin dakord që të arrijnë marrëveshje.

Bashkëpunimi gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit

Gjatë muajit shtator vazhdoi interesimi i publikut për transferimin e mundshëm të "Makpetroll" SHA Shkup nga "Balkan Petroleum Holding Limited".

Komisioni për letra me vlerë i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e 98 të datës 19 shtator 2016, miratoi Konkluzion për ndërprerjen e procedurës së ngritur sipas kërkesës për lëshimin e lejes për ofertë për transferimin e "Makpetroll" SHA Shkup, të paraqitur nga ana e "Balkan Petroleum Holding Limited".

² http://www.upoz.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=407:2016-09-13-11-53-33&catid=1:latest-news

³ <http://www.slobodnaevropa.mk/a/27842287.html>

⁴ <http://www.akademik.mk/naroden-pravobranitel-sudskata-administratsija-so-pravo-se-chuvstvuvana-diskriminirano-poradi-neednakvata-raspredelba-na-sredstvata-za-sudskata-vlast/>

⁵ <http://vistinomer.mk/sudskiot-budhetski-sovet-ne-smee-kolektivno-da-gi-namali-platite/>

Siç njoftoi Komisioni, procedura u ndërpre për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake te një organ tjetër kompetent shtetëror. Procedura në lidhje me kërkesën për lëshimin e lejes për ofertën e transferimit të “Makpetroll” SHA Shkup, të parashtruar nga ana e “Balkan Petroleum Holding Limited”, do të vazhdoj pas zgjidhjes së çështjes paraprake nga ana e organit kompetent shtetëror.

Në fillim të muajit shtator të vitit 2016, ministri i Drejtësisë, Valdet Xhaferi dhe Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Republikën e Maqedonisë Çarls Gareth nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi për avancimin e sistemit të praktikës gjyqësore përmes shfrytëzimit të modelit të sistemit gjyqësor britanik, traditës dhe kulturës së tij. Qëllimi i Memorandumit është edhe përforsimi i pavarësisë së gjyqësorit, përmirësimi i kapaciteteve të gjyqtarëve, rritja e besimit të qytetarëve në sistemin e jurisprudencës. Qëllimet konsistojnë me përforsimin e parimeve kyç: konsekuencë, koherencë, siguri juridike, parashikueshmëri dhe transparencë.

Së këtejmi, theksohet se të gjitha bizneset, pavarësisht se a janë të vegjël ose të mëdhenj, lokal ose të huaj, kanë nevojë për sistem gjyqësor të cilit mund t'i besojnë, i cili do t'u ofrojë vendime të ndershme dhe të pavarura.

Zgjidhja alternative e kontesteve

Gjatë muajit shtator, pas përfundimit të pushimeve verore të gjykatave dhe me fillimin e sërishëm të seancave gjyqësore, përsëri u intensifikuan edhe aktivitetet në fushën e ndërmjetësimit.

Në këtë periudhë aktivisht veprojnë 9 (nëntë) ndërmjetësues të licencuar të dhënat kryesore për kontakt të të cilëve janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, madje vërehet edhe rritja e interesimit sa u përket informacioneve për procedurën e ndërmjetësimit nga personat e interesuar të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike nga ndërmjetësues.⁶

Për shkak të interesimit të rritur të palëve dhe të autorizuarve të tyre për procedurën e ndërmjetësimit, veçanërisht në pjesën e zbatimit të ndryshimit të dispozitës ligjore në LPK me të cilin është inkorporuar përpjekja e detyrueshme për ndërmjetësim në kontestet ekonomike, të cilat kanë të bëjnë me kërkesa monetare deri në 1.000.000,00 (një milion) denarë për të cilat procedura ngritet me padi deri te gjykata kompetente, kështu që paraqitet nevoja e themelimit urgjent të Dhomës së Ndërmjetësuesve e cila do të paraqiste formë organizative në të cilën do të organizohen ndërmjetësuesit e licencuar, si dhe nevoja e miratimit të akteve nënligjore me qëllim të harmonizimit të punës së ndërmjetësuesve gjatë procedimit dhe veprimit të lëndëve të cilat i regjistrojnë në bazë të kërkesës së palëve të interesuara për ndërmjetësim.⁷

Sa i përket numrit të rasteve të regjistruara dhe të kryera të ndërmjetësimit, në Regjistrin e evidentimit të procedurave për ndërmjetësim, të cilin e udhëheq Ministria e Drejtësisë – Sektori për punë me noterë, përbarues dhe ndërmjetësues, në muajin shtator janë regjistruar gjithsej 9 (nëntë) raste të ndërmjetësimit konform raporteve të siguruar të cilat ndërmjetësuesit e licencuar i dërgojnë në Ministri.⁸

Nga gjithsej nëntë procedua të regjistruara të ndërmjetësimit, marrëveshje është arritur për një lëndë, ndërsa në 8 (tetë) lëndët e tjera ndërmjetësimi fare nuk ka filluar meqë palët nuk kanë treguar interesim për zgjidhje jashtëgjyqësore të kontestit.

Ende pritet që të arrihen rezultate të rëndësishme pozitive nga inkorporimi i përpjekjes së detyrueshme të ndërmjetësimit me ndryshimet e LPK të cilat hynë në fuqi nga muaji shkurt i vitit 2016. Megjithatë, ndërmjetësuesit të cilët punonin sipas akteve të vjetra normative për ndërmjetësim, të cilët janë shfuqizuar dhe të njëjtit nuk posedojnë licencë, përkatësisht nuk i

⁶http://www.pravda.gov.mk/documents/medijatori_2.pdf

⁷<http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=289>

⁸Të dhëna zyrtare nga Ministria e Drejtësisë

nënshtrohen provimit për ndërmjetësues, akoma figurojnë si anëtarë të Dhomës së Vjetër të Ndërmjetësuesve (e cila ligjërisht akoma ekziston, edhe pse nuk është aktive) dhe veprojnë sipas kërkesave të palëve të interesuara për zbatimin e ndërmjetësimit. Në mungesë të Dhomës së Re të Ndërmjetësuesve dhe iniciativës nga Ministria kompetente, për tejkallimin e këtij problemi sensitiv, është nevojë emergjente të përmirësohen gjendjet në mënyrë që të tejkallohet situata e keqe sa i përket mos-harmonizimit të kuadrit ligjor me atë juridik për ndërmjetësimit.⁹

Në lidhje me promovimin e ndërmjetësimit, gjatë muajit shtator, aktivitetet i intensivikoi edhe Asociacioni për Mbështetjen e Ndërmjetësimit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë. U mbajtën tre seminare njëditore falas në qytetet Prilep, Manastir dhe Shkup, me temë: “Ndërmjetësimi si mënyrë efikase e zgjidhjes jashtëgjyqësore të kontesteve”, ndërkaq target grup ishin përfaqësuesit e sektorit të biznesit të cilët u njoftuan me parimet kryesore të procedurës së ndërmjetësimit, me dallimet e procedurës gjyqësore, si dhe me atë se cilat konteste mund të ndërmjetësohen dhe cilat jo, përkatësisht në cilat raste mund t’i drejtohen ndërmjetësuesit.¹⁰

Aktivitetet e AMN në muajin shtator u fokusuan në drejtim të promovimit të broshurës për popullarizimin e ndërmjetësimit me moton: “Promovim – Afirmim – Sukses” në konferencë për shtyp të mbajtur në ambientet e Dhomës Ekonomike të Maqedonisë në të cilën u promovua edhe internet faqja e Asociacionit.¹¹

Në periudhën nga 26 shtatori deri në 28 shtator, në Shkup u mbajt një trajnim për zgjidhjen paqësore të kontesteve të punës, sipas standardeve ndërkombëtare të ONP (ILO), në të cilin u trajnuan 17 persona¹². Trajnues në këtë trajnim ishin tre anëtarë të cilët njëkohësisht janë edhe pjesë e themeluesve të APARS dhe trajnues të certifikuar për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës nga ITC pranë ONP (ILO). Njëri nga trajnuesit është ndërmjetësues i licencuar sipas Ligjit për ndërmjetësimit.¹³

⁹ Të dhëna zyrtare nga gjykatat me kompetencë të zgjeruar/ intervista me ndërmjetësues të licencuar

¹⁰ <http://www.mchamber.org.mk/>

¹¹ www.apm.mk

¹² Intervistë me trajnues si pjesë e EU-funded Project *Promoting Social Dialogue*

¹³ Intervistë me trajnuesit për zgjidhjen me marrëveshje të kontesteve të punës